

**Ihr Dokument wurde in eine pdf Datei umgewandelt.
Es beginnt auf der nächsten Seite.**

Alte Officeformate können potentiell gefährliche Inhalte, wie Makros enthalten.
Nur aktuelle Officeformate (docx, xlsx) werden im Original zugestellt.

**Wenn Sie das Originaldokument benötigen, bitten Sie den Absender die Datei
in einem aktuellen Format abzuspeichern und erneut zu senden.**

Rückfragen bitte an: benutzerservice@ivl.de

Vielen Dank für Ihr Verständnis.

Theodor-Wuppermann-Schule · Postfach 10 11 40 · 51311 Leverkusen

Për
Prindërit, nxënëset dhe nxënësit e TWS

Ihr Schreiben:

Mein Zeichen:

Telefon: 02 14/8 76 39-11

Telefax: 02 14/8 76 39-25

E-Mail: 302@stadt.leverkusen.de

Datum: 10.08.2020



Mësimi fillon nga 12.08.2020

Të dashur prindër, të dashur nxënëse dhe nxënës,

shpresojmë që të jeni mirë dhe të keni kaluar pushime të këndshme. Gjendja aktuale e pandemisë së Koronavirusit ka fatkeqësisht edhe për këtë vit shkollor veçoritë e saj. Respektimi i rregullave të higjenes që janë në fuqi është më shumë se kurrë i rëndësishëm, për të pasur të gjithë shëndet të mirë në këtë kohë të veçantë.

Fillimisht dëshirojmë t'ju japim informacionet në vijim:

- Mësimi fillon për të gjitha nxënëset dhe të gjithë nxënësit e klasave 6 - 10 si edhe të IK-ve të mërkurën, më 12.08.2020 .
- Në javën e parë (12.08. – 14.08.2020) **klasat (5), 6, 7** dhe IK-të do të kenë mësim nga ora **08:00 – 11: 30h, klasat 8-10 nga 08:30 -12:00 h.**
- Të gjitha nxënëset dhe të gjithë nxënësit do të takohen në oborin e shkollës (vendet e shënuara) dhe do të shoqërohen nga mësueset/mësuesit kujdestare/ë. Nxënëset dhe nxënësit duhet të mbajnë distancën e duhur.
- Nxënëset dhe nxënësit do të marrin në fund të javës së parë një plan, se për cilat lënda do të zhvillohet mësimi në distancë. Ju bëjmë me dije, që mësimi në distancë do të vlerësohet njëloj si mësimi „normal“ në shkollë.
- Nëse fëmija juaj ka simptoma të Koronavirusit (temperaturë, kollë të thatë, humbje të shqisës së nuhatjes apo të shijimit, rrufë), mbajeni fëmijën në shtëpi dhe informoni menjëherë shkollën.
- Nëse fëmija juaj shkel qëllimshëm rregullat e mbrojtjes kundra sëmundjes, përjashtohet nga mësimi. Ky hap pasohet edhe nga ndëshkime të tjera nga shkolla.
- Ju lutem, jepini fëmijës suaj shumë maska me vete, sepse ato duhet të ndërrohen vazhdimisht. Mbani parasysh, që maskat duhet të lahen ose të ndërrohen.



••• sind mit dem Berufsahl-SIEGEL als Schule mit vorbildlicher Berufsorientierung zertifiziert.

- Ushqim të ngrohtë do të ketë që nga dita e hënë, 17.08.2020. Mënyra e funksionimit të mensës do t'i bëhet me dije më vonë fëmijës suaj.
- Ora mësimore e sportit do të zhvillohet në natyrë. Ju lutem, jepini fëmijës veshjet e përshtatshme.
- **Ceremonia e fes timit të ditës së parë së shkollës për klasën e 5-të** do të zhvillohet **të enjten, më 13.08.2020 në orën 12:30h**. Njëri prej prindërve mund ta shoqërojë fëmijën. Të gjithë pjesëmarrësit duhet të kenë maskë mbrojtëse.

Rregullat për nxënëset dhe nxënësit:

- Respekto të gjitha rregullat e higjenës, siç janë: larja e duarve, mbajtja e distancës, kollitja apo teshtitja në parakrah ë, etj.
- Mbaj maskë në oborrin dhe në të gjitha ambientet e shkollës. Edhe hunda duhet të mbulohet **GJITHMON Ë** dhe plotësisht nga maska. **Face-shields NUK LEJOHEN**.
- Para fillimit të mësimi prit mësuesin ose mësuesen tënd/e në oborrin e shkollës duke respektuar rregullat e distancës, në vendin e caktuar për klasën tënde, dhe shko brenda në shkollë i shoqëruar nga mësuesja/mësuesi. Kjo vlen edhe për mësimin që fillon pas pushimit.
- Dezinfekto duart kur hyn në shkollë, në mensë.
- Respekto rrugët e skicuara për të lëvizur në shkollë.
- Mësuesja ose mësuesi do të japë një vend të caktuar për t'u ulur. Qëndro ulur aty.
- Nëse ndërron klasat (psh. kur ke kurse) ulu në vendin e caktuar për ty. Më parë duhet ta dezinfektosh vetë vendin e caktuar për ty. Letrat dezinfektuese do t'i japë mësuesja juaj/mësuesi yt.
- Largohu nga ambientet e shkollës pas mbarimit të mësimi.

Ju urojmë të gjithëve një fillim të mbarë!

Me respekt

(Nënshkrimi i drejtorisë së shkollës)



••r sind mit dem Berufsahl-SIEGEL als Schule mit vorbildlicher Berufsorientierung zertifiziert.

Berufswahl- und
ausbildungsfreundliche
Schule